

V E N D I M
Nr.354, datë 29.8.1994

**PËR SHPËRBILIMIN E CILËSISË SË VEPRIMTARISË SPORTIVE PËR SPORTISTËT,
TRAJNERËT E GJYQTARËT DHE SHPËRBLIME TË TJERA PËR VEPRIMTARITË
SPORTIVE**

Me propozimin e Ministrisë së Kulturës, të Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të shpërblehet cilësia e veprimtarisë sportive për sportistët, trajnerët e gjyqtarët, si dhe të jepen shpërblime të tjera për kontributin e angazhimet në veprimtaritë sportive.

2. Mënyra e shpërblimit dhe fondet financiare për realizimin e këtyre shpenzimeve do të caktohen në varësi nga specifikat, profilet dhe nivelet sportive.

3. Mënyra e shpërblimit të jetë:

a) Sipas kontratës së lidhur, duke u mbështetur në fondet financiare që krijohen për këtë qëllim.

b) Sipas tarifave të përcaktuara në lidhjet 1,2,3,4,5 e 6 që i bashkëngjiten këtij vendimi.

c) Sipas tarifave të shpërblimit të organizatave ndërkombëtare për arbitrat vendas e të huaj, kur gjykojnë ndeshje ndërkombëtare.

Shpërblimi për fituesit në veprimtaritë e të rinjve të jetë 50 për qind e vlerës së shpërblimit të të rriturve, kurse për moshat më të reja shpërblimi të jetë 25 për qind të vlerës së të rriturve.

Pagesat e kryera sipas sistemit tarifor të indeksohen në raport me rritjen e pagave nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Në raste të veçanta, kur lind nevoja për shpërblimin e zërave të ngjashme që nuk i përmban sistemi tarifor, ky shpërblim do të caktohet nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve në bashkëpunim me Ministrinë e Financave.

3. Fondet financiare të krijohen:

a) Nga fondet e miratuara nga buxheti i shtetit.

b) Nga të ardhurat e veprimtarisë e të shërbimeve që ofrohen për këtë, sipas dispozitave të veçanta.

c) Nga të ardhurat prej 90 për qind nga fondi i siguruar nga shitja e biletave.

ç) Nga fondet financiare të akumuluar prej kontributit të fondacioneve e sponsorëve të ndryshëm dhe llogaritë sportive.

4. Ngarkohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrë udhëzimin në zbatim të këtij vendimi.

5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.207, datë 1.8.1990 "Për dhënien e shpërblimeve e të stimujve materialë në sektorin e fizkulturës dhe të sporteve", shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi